



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës – Ministarstvo Inostranih Poslova i Diaspora
Ministër of Foreign Affairs and Diaspora

Datë: 27.05.2024

**FTESË APLIKIMI PËR ANËTARË TË KOMISIONIT VLERËSUES PËR
PROJEKTPROPOZIMET**

Bazuar në thirrjen e shpallur më datë 24/05/2024 për projekt propozime për mbështetjen dhe financimin e OJQ-ve për veprimtari dhe angazhim në kuadër të diasporës dhe mërgatës, në nenin 8 pika 3.2 të Rregullores MF-NR-04/2017 për Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës fton organizatat jo qeveritare/shoqërinë civile/njohësit e fushave: art, kulturë dhe sport, të aplikojnë për pjesëmarrje në komisionin e vlerësimit të projekteve:

- 1. përfaqësues nga OJQ-të (një anëtar);**
- 2. ekspert për vlerësimin e projekteve (një anëtar).**

Përfaqësuesit e lartcekur do të jenë anëtarë të komisionit për vlerësimin e projekt propozimeve të organizatave joqeveritare (OJQ) në fushën e diasporës dhe mërgatës, të pranuar nga MPJD, sipas thirrjes publike, e shpallur më 24.05.2024.

Të drejtë aplikimi kanë:

1. Të punësuarit në organizatat jo-qeveritare aktive në Republikën e Kosovës;
2. Njohës të fushave të artit, kulturës, dhe sportit në diasporë;

Të interesuarit për aplikim për anëtar të komisionit duhet t'i plotësojnë kërkesat e përgjithshme të ftesës publike:

1. të kenë përvojë në përgatitjen dhe zbatimin e projekteve të financuara nga burimet publike;
2. të kenë përvojë në vlerësimin e kërkesave të paraqitura në thirrjet për mbështetje financiare nga burimet publike;

3. t'i njohin dokumentet strategjike dhe politikat në fushën e diplomacisë publike;
4. t'a njohin bazën ligjore në fuqi në fushat që mbulon ftesa publike;
5. t'i njohin metodologjitë vlerësuese në komisione të ngjashme;
6. të kenë njohuri rreth dokumenteve të tjera relevante në fushën, për të cilën është hapur ftesa publike;
7. njohje e legjislacionit në fushën e mbështetjes financiare;
8. Të mos jenë të emëruar politik, shërbyes civil apo pozita të ngjashme në administratën shtetërore.

Periudha e angazhimit do të jetë sipas afateve kohore të përcaktuara në Rregulloren MF – nr.-04/2017 për Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.

Pagesa do të jetë 430 euro për anëtar.

Afati për aplikim është 5 ditë, nga data 27.05.2024 deri më 31.05.2024, në orën 16.00.

CV-të duhet të dërgohen në e-mail adresën: projekte.diaspora@rks-gov.net - në subjekt të shkruhet **pozita për anëtar të komisionit, për të cilën aplikoni.**

Aplikoj si përfaqësues nga OJQ-të

apo

Aplikoj si ekspert në vlerësimin e projekteve

Me respekt,

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës